

LANGUAGE ERRORS IN TRANSLATED TEXTS OF PRIMARY
EDUCATION
GABIMET GJUHËSORE NË TEKSTET E PËRKTHYERA TË
ARSIMIT FILLOR

Shejnaze AJDINI-MURTEZI¹, Dëfrim SALIU², Besa SALIU³

^{1*} Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje

² Department of French Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

³ High School of Music „Todor Skalovski - Tetoec” - Tetovo

*Corresponding author e-mail: sheajdini@hotmail.com

Abstract

The textbook, as a central element in pedagogical practice, is considered one of the most effective factors in improving the quality of teaching/ learning, especially in countries where education systems lack other tools. At the same time, it also serves as a major resource for learning standard language. In this context, for the success or failure to achieve the aims set out in the curricula, for the acquisition of knowledge from different subjects, as well as for the study of the standard language, textbooks play the main role in schools. The process of compiling and publishing textbooks, as in many other countries, in North Macedonia too, is an institutional responsibility and is based on a program and policy approved and implemented by the Ministry of Education. During the compilation and publication of textbooks, special importance is given to the full implementation of the rules of the norms of standard language.

Unfortunately, it should be noted that even after almost half a century since the Orthography Congress, textbooks for primary and secondary schools, for most subjects, continue to be translated mainly from the Macedonian language. In these translated texts, we observe many deviations from the literary norm of the Albanian language. Precisely for this reason, in this research, the language of the texts translated for the primary education will be treated, whereas, as a basis will use the book: *Society* for the fifth grade of nine-year primary education.

Keywords: *Errors, textbook, language, translated, society.*

Përmbledhje

Teksti shkollor, si një element qendror në praktikën pedagogjike, konsiderohet si një nga faktorët më efikas në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies/mësimnxënies, veçanërisht në shtetet ku sistemeve arsimore u mungojnë mjete tjera. Njëkohësisht, ai shërben edhe si një burim kryesor për mësimin e gjuhës standarde. Në këtë kontekst, për suksesin apo mosp suksesin e arritjes së qëllimeve të përcaktuara në programet mësimore, për nxënien e njohurive nga lëndë të ndryshme, si edhe për nxënien e gjuhës standarde, rolin kryesor në shkollë e kanë tekstet shkollore. Procesi për përpilimin dhe botimin e teksteve shkollore, si në shumë vende tjera, edhe në RMV është përgjegjësi institucionale dhe mbështetet në një program dhe politikë të miratuar dhe zbatuar nga Ministria e Arsimit.

Gjatë përpilimit dhe botimit të teksteve shkollore rëndësi të veçantë ka edhe zbatimi i plotë i rregullave të normës së gjuhës standarde. Për fat të keq, duhet theksuar se edhe pas, pothuajse, një gjysëm shekulli nga mbajtja e Kongresit të Drejtshkrimit, tekstet mësimore për shkollat filllore dhe të mesme, për shumicën e lëndëve, vazhdojnë të përkthehen, edhe atë, kryesisht nga gjuha maqedonase. Në këto tekste të përkthyer vërehen mjaft shkarje nga norma letrare e gjuhës shqipe. Pikërisht, për këtë arsye në këtë kumtesë do të trajtohet gjuha e teksteve të përkthyer në arsimin fillor, ku për bazë do të na shërbejë libri: *Shoqëria për klasën e pestë për arsimin fillor nëntëvjeçar*.

Fjalët kyçe: *Gabime, tekst shkollor, gjuha, përkthyer, shoqëria.*

1. Hyrje

Roli dhe funksioni i teksteve shkollore në procesin e informimit, arsimimit dhe edukimit të nxënësve, vazhdon të jetë i pazëvendësueshëm dhe rrjedhimisht, cilësia e teksteve shkollore ka një rëndësi të veçantë për të ardhmen dhe karrierën e nxënësve. Megjithatë, në mënyrë të vazhdueshme ka pasur vërejtje e kritika në adresë të teksteve shkollore, nga mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, e po ashtu edhe nga ekspertët dhe njohësit e kësaj çështjeje.²⁸⁸

Duke u nisur nga rëndësia që kanë tekstet shkollore në procesin e arsimimit dhe edukimit të nxënësve, si edhe duke i marrë parasysh vërejtjet që i janë bërë këtyre teksteve si nga ana e mësimdhënëseve, nxënësve e prindërve, ashtu edhe nga ana e gjuhëtarëve e studiuesve të çështjes në fjalë, mund të konstatohet se këto tekste shkollore të përkthyer lënë shumë për të dëshiruar.

Pikërisht, për këtë arsye në këtë kumtesë do të trajtojmë gjuhën, gjegjësisht, gabimet gjuhësore drejtshkrimore, morfologjike, sintaksore, leksikore e semantike. Për t'i parë më mirë këto gabime, kemi analizuar librin: Shoqëria për klasën e pestë për arsimin fillor nëntëvjeçar në gjuhën shqipe duke e krahasuar me origjinalin e shkruar në gjuhën maqedonase. Në këtë tekst të përkthyer vërehen mjaft shkarje nga norma letrare e gjuhës shqipe.

Nëpërmjet një analize të hollësishme gjuhësore të këtij teksti në gjuhën shqipe, dhe duke e marrë për krahasim tekstin origjinal në gjuhën maqedonase, do të mundohemi t'i vëjmë në pah gabimet gjuhësore që janë bërë gjatë përkthimit, si mospërdorimi me vend i emrave në rase, përkthim i fjalëpërfjalshëm, gabime leksikore e semantike etj.. Por, meqë kemi hasur në një mori gabimesh të këtilla, e të cilat nuk do të mund përfshiheshin në këtë punim përshkak të volumit të gjërë, ne jemi përcaktuar vetëm për disa sosh. Për arsye praktike këto gabime i kemi ndarë në disa fusha.

Pra, qëllimi kryesor i kësaj kumtese është që nëpërmjet vërejtjeve, por edhe këshillave të kontribuojmë në mënjanimin e këtyre mangësive gjatë përpilimit të teksteve shkollore në të ardhmen, në mënyrë që të njëjtët të jenë të një cilësie më të lartë, si përmbajtjesore ashtu edhe gjuhësore.

2. Shqyrtime teorike

Përkthimi ka të bëjë me përshtatjen e një teksti të shkruar nga një gjuhë në tjetrën, duke e përcjellë mesazhin në mënyrë sa më të besueshme. Përgjithësisht, përkthyesi përkthen nga gjuha e dytë ose e tretë në gjuhën e amtare. Ai duhet të jetë i pajisur me një kulturë të gjërë, një shkathhtësi më të madhe mendore, një njohje të mirë dhe aftësi hartimi të gjuhëve që i përdor. Përkthimi sot paraqet sfida të shumta, të shkaktuara nga globalizimi dhe zhvillimi i teknologjive të reja. Sipas Umberto Eco-s, të përkthesh do të thotë «të thuash pothuajse të njëjtën gjë në një gjuhë tjetër» (2007:9).

Në lidhje me përkthimin, Georges Mounin pohon se «përkthimi mëton të prodhojë në gjuhën e synuar (B), barasvlerësin natyror sa më të përafërt të mesazhit të gjuhës së burimit (A), pikësëpari sa i përket kuptimit, pastaj edhe stilit» (1963:XII). Sipas Tatilon, të përkthesh do të thotë «të riformulosh një tekst në një gjuhë tjetër duke u kujdesur në ruajtjen e përmbajtjes» apo për më tepër «përkthimi është një veprim që ka për qëllim të prodhojë, sipas modelit të tekstit burimor, një tekst në gjuhën e synuar ku informacioni në çdonjërin prej aspekteve të tij, si referencial, pragmatik, dialektor ashtu edhe stilistik, të jetë, aq sa është i mundur, i afërt me përmbajtjen e tekstit burimor » (Tatilon, 1986:7).

²⁸⁸ <https://dokumen.tips/reader/f/problemet-dhe-te-metat-e-teksteve-shkollore>

Në lidhje me rolin e pakontestueshëm të përkthyesit, Xhevat Lloshi shprehet: „Përkthyesi është ambasadori nga një gjuhë në një tjetër, nga një kulturë në një tjetër; është përcjellësi i kumtit, që nuk ia shton fajet kumtit, por përkundrazi, përpiket me gjithë dijet dhe aftësitë e tij të përcjellë jo vetëm besnikërisht një përmbajtje, por edhe ta përcjellë atë me gjithë informacionin, me gjithë shijen dhe me vlerat estetike” (2020:154). Pavarësisht shumëllojshmërisë së burimeve, si interneti, mediumet audio-vizuele, tekstet shkollore në RMV ende konsiderohen si burimi kryesor i informacionit dhe pothuajse i vetmi për realizimin e mësimit të gjuhës standarde në shkolla.

Në këtë kontekst, për suksesin apo mospë suksesin e arritjes së objektivave të përcaktuara në programet mësimore, për nxënien e gjuhës standarde, rolin kryesor në shkollë e kanë tekstet mësimore. Pra, ai njihet si një nga faktorët më efikas për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies/mësimnxënies. Është fakt i pamohuar se gjuha e librave mësimorë ka rol dhe rëndësi vendimtare si për rritjen cilësore të mësimdhënësit, ashtu edhe për formimin gjuhësor të nxënësve, me qëllim që ata të përvetësojnë sa më mirë gjuhën letrare kombëtare, të bëhen të ndërgjegjshëm për vlerat dhe dobinë e saj dhe ta përdorin atë si mjet zhvillimi e përparimi në jetën e përditshme dhe të ardhmen e tyre prosperuese.

Angazhimi për të mundur një mënyrë dhe qasje më të lehtë në përvetësimin e gjuhës standarde shqipe ka qenë i vazhdueshëm dhe nuk ka ndaluar përgjatë dekadash. Kështu, duhet risjellë në kujtesë se pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) është bërë një punë e gjerë dhe e larmishme për përmirësimin gjuhësor të programeve dhe të librave mësimorë. Janë bërë përpjekjet për t'i ndërtuar ato mbi baza të shëndosha shkencore, duke pasqyruar gjithnjë e më mirë arritjet e shkencës gjuhësore shqiptare (IASH, Gjuha Jonë 1-4, 1993:106).

Librat dhe tekstet shkencore bëjnë pjesë në përkthimet që «vetvetiu nënkuptohen» sepse ato janë sa të nevojshëm aq edhe të dobishëm. Duke u nisur nga fakti numër i madh hulumtimesh shkencore vjen nga anglo-sankonët, rrjedhimisht edhe të njëjtat përkthehen edhe në gjuhë të tjera. Këtu, duhet theksuar se në ish- Jugosllavi, pothuajse të gjitha përkthimet e teksteve shkollore në shqip vinin nga serbo-kroatishja, dhe jo nga origjinali, nga anglishtja për shembull, siç ndodh edhe tani në RMV, ku shumica e teksteve janë të përkthyer nga gjuha maqedonase, madje edhe tekstet që janë në gjuhën angleze.

Gjatë procesit të përpilimit dhe botimit të teksteve mësimore, padyshim që rëndësi të madhe ka zbatimi i plotë i rregullave të normës së gjuhës standarde. Po, fatkeqësisht, edhe pas pothuajse një gjysëm shekulli nga mbajtja e Kongresit të Drejtshkrimit, tekstet mësimore për shkollat fillore dhe të mesme në RMV, për shumicën e lëndëve, vazhdojnë të përkthehen, edhe atë, kryesisht nga gjuha maqedonase. Në këto tekste të përkthyer vërehen mjaft shkarje nga norma letrare e gjuhës shqipe. Me të drejtë parashtrohet pyetja se a ka nevojë të përkthehen librat shkollorë nga gjuha maqedonase, kur ka mjaft dijetarë shqiptarë që do të mund t'i hartonin këto libra në gjuhën amtare.

Në lidhje me këtë shprehet edhe Avzi Mustafa: „Shumë tekste përveç gjuhës amtare, i hartojnë autorë maqedonas dhe unë pyes se vallë aq të paaftë janë shqiptarët që të mos mund të hartojnë tekste edhe në fushat e tjera të diturisë. Në ato libra ku paraqiten vetëm autorë maqedonas, përkthimet në gjuhën shqipe janë tejet të dobëta. Përkthimi nuk i ngjan gjuhës shqipe”.²⁸⁹ Ai shpreh shqetësimin për gjendjen kaotike lidhur me tekstet shkollore.

Edhe pse problemi i teksteve është i dyfishtë, pra si nga ana përmbajtjesore, ashtu edhe ajo gjuhësore, ne në këtë punim jemi përcaktuar të trajtojmë aspektin gjuhësor, gjegjësisht, gabimet e shumta gjuhësore që i kemi hasur në librat e përkthyer në gjuhën shqipe. Në shumë tekste shkollore hasim në gabime gjuhësore të natyrave të ndryshme, si: drejtshkrimore (fonetike e morfologjike), mospërshtatje në gjini të mbiemrit me emrin, mospërdorimin me

²⁸⁹ Avzi Mustafa, DW, *BALLKANI (Pas protestës, reagimi: Tekstet shkollore në Maqedoni do të rishqyrtohen, 06.09.2010)*.

vend të emrave në rasa, përdorim i gabuar i nyjes së përparme, mospërshtatje e kryefjalës me kallëzuesin, përkthim të fjalëpërfjalshëm, renditje e gabuar e fjalëve në fjali etj.

Për t'i parë më mirë këto gabime, kemi analizuar tekstin shkollor: SHOQËRIA PËR KLASËN E PESTË PËR ARSIMIN FILLOR NËNTËVJEÇAR nga autorët Violeta Mitovska, Olivera Veliçkovska, Vesna Gavrilovska-Avramovska, 2010, Shkup, të përkthyer në gjuhën shqipe, duke e krahasuar me origjinalin e hartuar në gjuhën maqedonase (ОПШТЕСТВО ЗА ПЕТТО ОДДЕЛЕНИЕ ЗА ДЕВЕТГОДИШНО ОСНОВНО ОБРАЗОВАНИЕ). Gjatë analizës së këtij teksti, kemi nxjerrë disa shembuj ku vërehen më së miri gabimet gjuhësore të cilat janë lëshuar gjatë përkthimit të të njëjtit dhe njëkohësisht kemi dhënë edhe formën e drejtë. Meqë në të njëjtën fjali na shfaqen njëkohësisht më shumë shkarje gjuhësore, për qëllime pragmatike, i kemi ndarë si në vijim: gabime drejtshkrimore, morfosintaksore dhe leksiko-semanticke.

3. Gabimet drejtshkrimore

Gabimet drejtshkrimore, si fonetike ashtu edhe morfologjike, janë të shumta, por ne i kemi nxjerrë vetëm disa sosh:

versioni shqip

- f. 8. Gjejini shtetet fqinjë...(drejt: Gjeni)
- f. 12. Ura e Gurrit...(drejt: Ura e Gurit)
- f. 13. teatra,...(drejt: teatro)
- Ndajuni në grupe...(drejt: Ndahuni)
- f. 18. Ekspanzion më të madhë...(drejt: madh)
- f. 20. ... e Imperisë otomane (drejt: Perandorisë)
- f. 22. Barë të madh...(drejt: barrë të madhe)
- f. 23. Për Maqedonin...(drejt: Maqedoninë)
- f. 28. ... rënditi me emrin: UDHËTIMKOHORË...
(drejt: renditi me emrin UDHËTIM KOHOR) ВРЕМЕПЛОВ
- f. 32. ...të ritur,...(drejt: të rritur)
- f. 86. ... është themeluarë...(drejt: themeluar)_
- ...e kanë bashkuarë (drejt: bashkuar)
- f. 92. ...Maqedonisë morri...(drejt: mori)
- f. 99. ...zhvillimit ekonomikë (drejt: ekonomik)

versioni maqedonisht

- Пронајдете ги соседните држави...
- Камениот мост...
- театри, ...
- Поделете се на групи
- Најголем успех ...
- ... на Османлиската Империја
- Голем товар...
- За Македонија ...
- подредете ги сите под еден наслов:
- ... возрасни, ...
- ... е основана ...
- ... го обединиле
- ... Македонија се стекна
- ... економски развој

4. Gabimet morfosintaksore

versioni shqip

- f. 5. DO TË MËSOJMË PËR:
- Maqedonia si pjesë e Evropës dhe Ballkani;
- Balkanot;

versioni maqedonisht

- ЌЕ УЧИМЕ ЗА:
- Македонија како дел од Европа и од

Duke u bazuar në kuptimin e versionit origjinal, përkthimi i drejtë do të ishte: DO TË MËSOJMË PËR: Maqedoninë si pjesë e Evropës dhe Ballkanit. Pra, emri Maqedonia është vënë gabimisht në rasën emërore, në vend që të vihet në rasën kallëzore (Maqedoninë). Edhe emri Ballkani është vënë në rasën emërore, në vend që të vihet në rasën gjinore (Ballkanit).

versioni shqip

f. 7. Në *republikën* populli e zgjedh pushtetin në zgjedhje demokratike për disa vite të caktuara.

versioni maqedonisht

- Во републиката власта ја избира народот на демократски избори за определен број години.

versioni shqip

f. 22. Në *luftën* kanë marrë pjesë edhe ...

f. 41. Në *bibliotekat*, përveç libra,...

versioni maqedonisht

- Во војната учествувале и ...

- Во библиотеките, освен книги, ...

Fjalitë e mësipërme (f. 7, 22, 41) janë përkthyer me sintaksë të gjuhës maqedonase, përshkak se emrat *republikën /luftën/ bibliotekat* (rasa kallëzore), të paraprirë nga parafjala *në*, janë vënë gabimisht në trajtën e shquar. Parafjalët që drejtojnë rasën kallëzore janë: *në*, *mbi*, *nën*, *nëpër*. Në këto ndërtime emri bën punën e një gjymtyre të dytë të fjalisë, zakonisht të një rrethanori, dhe shpreh raporte të ndryshme kohe e vendi. Meqenëse këtu kemi të bëjmë me një dukuri të rëndomtë e të lashtë, që ka fituar tiparet e një formule, edhe në rastet kur emri nga kuptimi është i caktuar, pas këtyre parafjalëve ai vihet në trajtën e pashquar (Agalliu et al., 1995:130). Trajtat e shquara të emrave mund të përdoren në kallëzoren e trashëguar kur emrat shoqërohen me një përcaktor, p.sh. në Kosovën e trimave,... (Topalli, 2009:322). Fjalja *u ngjita në malin* është e pamundur në qoftë se emri nuk shoqërohet me një përcaktor (Topalli, 2009:326).

Pra, në rastin tonë, emrat i *republikën/luftën/ bibliotekat* nuk janë të shoqëruar me një përcaktor (p.sh. siç mund të ishte: në Republikën e Maqedonisë), prandaj si të tillë nuk mund të vihen në trajtën e shquar. Format e drejta të këtyre emrave në fjalitë e mësipërme duhet të ishin *republiکہ /luftë /biblioteka* (trajta e pashquar). (Drejt: Në *republiکہ*, populli e zgjedh pushtetin (qeverinë) ...; Në *luftë* kanë marrë pjesë edhe...; Në *biblioteka*, përveç libra,...).

versioni shqip

f. 14. Ajo paraqet *udhëkryq* i rrugëve më të rëndësishme i cili na lidh me shtetet ballkanike.

versioni maqedonisht

Таа претставува крстосница на значајни патишта која не поврзува со сите балкански држави.

Në fjalinë më lart, emri *udhëkryq* është vënë gabimisht në trajtën e pashquar. Emri del në trajtën e shquar kur ndiqet nga një përcaktor i rasës gjinore. Gjinatorja nga kuptimi afrohet me përemrin pronor, sepse edhe ajo përdoret me kuptim përkatësie, prandaj shkaku i shquarsisë mbetet po ai. P.sh. *Gjëmimi* i topave... (Agalliu et al., 1995:124). Kjo do të thotë se emri *udhëkryq* pasi ndiqet nga një përcaktor i rasës gjinore, duhet të vihet në trajtën e shquar. Gjithashtu, në këtë fjali, *nyja* e përparme /i/ është përdorur gabimisht në vend të /të/.

„Për sa u takon formave /të/ dhe /e/ „të nyjave të përparme”, që në shqipen e dokumentuar përdoren pas një emri të gjinisë mashkullore e femërore në rasën kallëzore njëjës, të gjinisë asnjansë në rasat emërore e kallëzore njëjës dhe të të tria gjinive në rasat emërore e kallëzore shumës, duhet pasur parasysh se burimisht ato nuk janë dy variante por dy forma nyjore të ndryshme[...]. Siç dihet, forma nyjore /e/ përdoret menjëherë pas formës së shquar të emrit paraprijës, kurse forma /të/ del në kushte të tjera sintaksore” (Demiraj, 2015:134). Kjo fjali do të duhej të ishte si në vijim: Ajo paraqet *udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme i cili na lidh me shtetet ballkanike*.

versioni shqip

f. 22. ...në 2 gusht të vitit 1903.

versioni maqedonisht

- ... на 2 август 1903 година.

Në këtë fjali parafjala *në* është përdorur gabimisht në vend të parafjalës *më*. Parafjala **më** shkruhet kurdoherë para datave, kur ato përdoren si plotës kohe brenda një fjalie: *Kongresi u hap të hënë, më 20.XI.1972; Mbledhja bëhet të shtunën, më 1 shtator 1973 etj.* (IAP, 1974:104). Pra, thuhet: *më 2 gusht të vitit 1903.*

versioni shqip

f. 10. *Nga mesi i saj deri në skaje të flamurit, është i shpërndarë dielli me tetë rrezet e saja.*

versioni maqedonisht

- Знамето на Република Македонија е црвено. Од средината кон краевите на знамето, распослано е жолтото сонце со осум краци.

Fjalja e mësipërme ka një renditje fjalësh të palogjikshme sa që e bën atë të pakuptueshme. Pra, kemi: *Nga mesi i saj*, ku, në fakt, përemri pronor *i saj*, që është i gjinisë femërore, i referohet emrit *flamurin*, që siç dihet mirë, është gjinia mashkullore, në vend se të thuhet nga mesi *i tij*. Pastaj, në vazhdim të së njëjtës fjali kemi, gjithashtu, mospërputhje në gjini të emrit *dielli* me përemrin pronor *e saja*. Duke e marrë për bazë kuptimin e kësaj fjalie në gjuhën maqedonase, e njëjta do të duhej të përkthehej si në vijim: *Dielli me tetë rrezet e tij është i shpërndarë duke filluar nga mesi e deri në skajet e flamurit.*

versioni shqip

f. 86. *Unioni Evropian me formimin e saj mundësoi...*

versioni maqedonisht

- Европската Унија со своето создавање овозможи...

versioni shqip

f. 88. *Këshilli i BE-së, i njohur edhe si Këshilli i Ministrave, është institucion udhëheqës, i cili përfaqëson interesat e të gjitha vendeve anëtare. Ka 27 anëtarë. Detyrat e saja janë...*

versioni maqedonisht

- Советот на ЕУ, уште познат како Совет на министри, е водечка институција, која ги претставува интересите на сите земји членки на Унијата. Негова надлежност се...

Edhe në këto dy fjali kemi mospërshtatje në gjini të përemrit pronor me emrin (f. 86. përemri *e saj* me emrin *Unioni Evropian* dhe f. 88. përemri *e saja* me emrin *Këshilli i BE-së*). (Drejt: *Unioni Evropian me formimin e tij mundësoi...* dhe *Këshilli i BE-së, i njohur edhe si Këshilli i Ministrave, është institucion udhëheqës, i cili përfaqëson interesat e të gjitha vendeve anëtare. Ka 27 anëtarë. Detyrat e tij janë...*).

versioni shqip

f. 14. *Ndër të tjera më i rëndësishëm është autostrada E-75 dhe hekurudha Shkup-Gjevgjeli.*

versioni maqedonisht

- Најзначајни сообраќајници се автопатот E-75 и железничката пруга Скопје-Гевгелија.

Siç shihet mirë, në fjalinë më lart nuk ka përshtatje të mbiemrit i rëndësishëm (gj. m.) as në gjini, por as në numër me emrat *autostrada* (gj.f.) dhe *hekurudha* (gj.f.). Meqë mbiemri i njëjtë i cilëson këta dy emra njëkohësisht, ai duhet të vihet në numrin shumës, gjinia femërore (drejt: *Rrugët më të rëndësishme janë autostrada E-75 dhe hekurudha Shkup-Gjevgjeli*).

versioni shqip

f. 20. *Kryengritja e madhe e parë në Maqedoni ...*

versioni maqedonisht

- Првото поголемо востание во Мак....

Edhe në këtë fjali kemi renditje jo të rregullt të fjalëve në fjali, por edhe përkthim jo adekuat të mbiemrit *e madhe* (shkalla pohore) nga *поголемо* (shkalla krahasore), gjë e cila e bën atë të palogjikshme. (Drejt: *Kryengritja e parë më e madhe në Maqedoni...*).

versioni shqip

f. 99. *Zhvillimi i teknologjisë, posaçërisht në pjesën e këmbimit të informacioneve dhe në komunikacion - internet, luajnë një ndër rolet më të rëndësishme në zhvillimin e botës globale.*

versioni maqedonisht

- Технолошките новини, посебно напредокот во областа на размена на информации и на комуникации- интернет, играат една од од најзначајните улогу во настанувањето и во развитокот на глобалниот.

Në tekstin e analizuar kemi vënë re edhe mospërshtatja të kryefjalës me kallëzuesin, siç është rasti edhe me fjalinë e fundit, ku kryefjala është në njëjës *Zhvillimi* është në njëjës, ndërsa kallëzuesi *luajnë* është në shumës (drejt: *Zhvillimi i teknologjisë ... luan...*).

5. Gabimet leksiko-semantike

versioni shqip

f. 17. *oranzherive*.

versioni maqedonisht

- оранжерииите.

Fjala *oranzherive* nuk i përket fjalorit të gjuhës shqipe, ajo është marrë si e tillë nga gjuha maqedonase, pa u përkthyer (drejt: *serrave*.).

versioni shqip

në të cilën ka shumë zanatçin

versioni maqedonisht

- во која има многу занаетчи

Edhe emri *zanatçin* nuk është përkthyer drejt, përshkak se ai si e tillë përdoret në disa të folme shqipe e që është huazim nga gjuha turke. Përndryshe, fjala *занаетчи* në gjuhën shqipe, siç dihet, përkthehet me fjalën *zejtarë*.

versioni shqip

f. 20. *Lëvizja e çlirimit*

versioni maqedonisht

- Ослободителното движење

Sigurisht se emri *çlirimit*, në rastin e mësipërm, është përdorur gabimisht në vend të mbiemrit *çlirimtare* (drejt është: *Lëvizja çlirimtare ...*).

6. Përfundimi

Duke u nisur nga të dhënat e analizës që i kemi bërë këtij teksti shkollor, mund të themi se kemi hasur në mjaft shmangie gjuhësore, si: gabime të shumta drejtshkrimore, mospërdorim me vend të emrave në rasa, mospërshtatje të kryefjalës me kallëzuesin, përkthim të fjalëpërfjalshëm me sintaksë të gjuhës maqedonase, fjali të palogjikshme e të pakuptueshme, gabime në përdorimin e nyjës së përparme, përdorim të fjalës së huaj në vend të fjalës shqipe etj. Përkthimi i teksteve shkollorë nga gjuha maqedonase në atë shqipe deri më tani nuk është treguar si një praktikë e mirë dhe nuk ka përmbushur kriteriumet themelore, jo vetëm përshkak të mungesës së përkthyesve profesionistë, por edhe përshkak të kujdesit jo në nivel të lektorëve, recensentëve, redaktorëve, botuesve, e të tjerëve, me një fjalë, të të gjithë atyre që janë përgjegjës për daljen në dritë të të njëjtëve.

Pikërisht, për këtë arsye ne mendojmë se tekstet shkollore duhet të hartohen nga një ekip profesionistësh, si autorë të specializuar në lëminë e caktuar, ashtu edhe përkthyes (nëse eventualisht mund të mos jenë angazhuar autorë shqiptarë në përpilimin e ndonjë teksti), lektorë, redaktorë, recensentë, botues etj., që do të thotë se tekstet shkollore duhet t'i nënshtrohen një sistemi të rreptë kontrolli në aspektin gjuhësor, po sigurisht pa e lënë anash aspektin përmbajtësor, i cili është i një rëndësie të veçantë për edukimin, arsimimin dhe përgatitjen e gjeneratave të reja për një jetë më cilësore dhe me vlera të larta shoqërore.

Dhe krejt në fund, siç janë shprehur edhe shumë intelektualë shqiptarë, ashtu edhe profesori universitar, Salajdin Saliu për Radion Evropa e Lirë,²⁹⁰ mendojmë se tani përfundimisht është koha që në Maqedoninë e Veriut të hartohen tekste origjinale në gjuhën shqipe, dhe të mos mundohen e detyrohen shkollarët tanë të mësojnë ende me tekste të përkthyer. Përpilimi i teksteve cilësore në gjuhën amtare, padyshim se do ta nxisë dëshirën e nxënësve për mësimnxënie, por njëkohësisht do të ndikojë edhe në kreativitetin e tyre.

Referencat

- [1]. Agalliu, F. et al. (1995). *Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia*, Tiranë: ASHRSH.
- [2]. Demiraj, Sh. (1986). *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë: 8 Nëntori.
- [3]. Instituti Albanologjik i Prishtinës (1974). *Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe*, Prishtinë.
- [4]. Instituti Albanologjik i Shqipërisë (1993). *Gjuha jonë 1-4*, Tiranë.
- [5]. Lloshi, Xh. (2020). *Shkrime rreth përkthimit*, Shkup: AZGJ.
- [6]. Mounin, G. (1963). *Les Problèmes théoriques de la traduction*, Paris: Gallimard.
- [7]. Tatilon, C. (1986). *Traduire. Pour une pédagogie de la traduction*, collection « Traduire, écrire, lire ». Paris: GREF.
- [8]. Topalli, K. (2009). *Sistemi rasori emrave të shqipes*, Tiranë: Plejad.
- [9]. <https://dokumen.tips/reader/f/problem-et-dhe-te-metat-e-teksteve-shkollore>
- [10]. <https://portalb.mk/499435-me-ligj-pritet-eliminimi-i-gabimeve-ne-tekstet-shkollore/>
- [11]. http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/fakulteti_edukimit/akademia_solemne.pdf

²⁹⁰ <https://portalb.mk/499435-me-ligj-pritet-eliminimi-i-gabimeve-ne-tekstet-shkollore/>